

Për botimin kritik të variantit në dorëshkrim të romanit *Dimri i vetmisë së madhe* të Ismail Kadaresë

Gjenetika e letërsisë është themelore.

Ismail Kadare

1. – Parashtresë

Pak më shumë se dy dekada më parë Francesco Altimari përuronte një fazë të re të fillogjisë tekstore në albanologji duke nxjerrë në dritë botimin kritik të veprës paradigmatiche të letërsisë së Rilindjes: poemën *Bagëti' e Bujqësija* të Naim Frashërit¹. Me këtë botim ai synonte të përvijonte një perspektivë të re kërkimi, që përveç veprave të autorëve të vjetër, të përfshinte edhe tekste më të reja, veçanërisht, ato të letërsisë bashkëkohore shqipe. Në këtë kuadër ngërthehet edhe ky botim kritikogjenetik i romanit *Dimri i vetmisë së madhe*, bazuar në dorëshkrimin që iu kthye Kadaresë nga fundi i vitit 2012 pasi fitoi çështjen gjyqësore kundër Nexhmije Hoxhës, e cila e kishte mbajtur dorëshkrimin për më se katër dekada. Fill pas vendimit të gjyqit që i dha të drejtë Kadaresë, më lindi ideja e botimit të dorëshkrimit me një qasje mirëfilli fillogjike.

Ideja u prit mirë nga Autori i cili aty nga fundi i vitit 2013, jo vetëm që më vuri në dispozicion gjithë korpusin e dorëshkrimeve origjinale, por mori një pozitë shkaputjeje neutrale, duke u besuar rezultateve që do të dilnin nga shqyrtimi i lirë fillogjik. Për besimin që dëshmoi ndaj meje i jam mirënjohës Kadaresë, i cili edhe në këtë rast konfirmoi ndjeshmërinë e tij si njeri dhe si artist: le të vlejë ky botim si homazh për tetëdhjetëvjetorin e tij².

2.– Korpusi i dorëshkrimeve

Korpusi dorëshkrimor përbëhet nga dy pjesë të veçanta: pjesa e parë, më e vëllimshmja, përbëhet nga qindra faqe dorëshkrim autograf me një variant të romanit dhe me titullin *Dimri i vetmisë së madhe*; pjesa e

1 Naim Frashëri, *Bagëti' e Bujqësija* (I pascoli e i campi). Introduzione, edizione critica, traduzione italiana e concordanza a cura di Francesco Altimari. CELUC, Rende 1995.

2 Gjatë punës ekdotike që është zhvilluar në tri faza – transkriptimi, ndërtimi tripjesësh i aparatit kritik dhe shënimet redaksionale përkatëse – kam përfituar nga ndihma e disa miqve dhe bashkëpunëtorëve, ndër të cilët dëshiroj të veçoj Gëzim Gurgën, të cilin e falënderoj për konsultimet e frytshme dhe për shqipërimin e kësaj parathënieje. Së fundi, përfitoj nga rasti t'i shpreh mirënjohjen Bujar Hudhrit dhe stafit të shtëpisë botuese “Onufri”, veçanërisht Enxhi Hudhrit, për ndihmën teknike që më dha gjatë kësaj pune.

dytë përbëhet nga fletë të daktilografuara të rishikuara dhe të ndrequra nga autori si edhe disa fletë dorëshkrim autograf që plotësojnë tekstin e daktilografuar.

Në të dyja rastet materiali paraqitet në gjendje shumë të mirë, i padëmtuar, me një shkrim të rrjedhshëm dhe të qartë. Më poshtë po japim një përshkrim analitik të dy materialeve, edhe pse, sikurse do ta shtjellojmë në paragrafin mbi premiset metodologjike dhe kriteret e botimit kritik, vëmendja do të përqendrohet tek i pari, që do ta quajmë *dsh. α*, për ta dalluar nga tjetri, që po e quajmë *dsh. β*.

2.1.– *Dorëshkrimi α*

Teksti i romanit është i ndarë në pesë pjesë. Sikurse edhe në botimin e vitit 1973, secila syresh përfshin një numër jo të njëjtë kapitujsh dhe faqesh për kapitull:

Pjesa e parë	nga	Kapitulli I	deri te	Kapitulli V	f.	168
Pjesa e dytë	“	Kapitulli VI	“	Kapitulli XI	“	207
Pjesa e tretë	“	Kapitulli XII	“	Kapitulli XIX	“	315
Pjesa e katërt	“	Kapitulli XX	“	Kapitulli XXIII	“	127
Pjesa e pestë	“	Kapitulli XXIV	“	Kapitulli XXVII	“	144

Gjithsej janë 961 fletë, një pjesë e të cilave mbajnë një numërtim autograf të dyfishtë, sikurse do ta shohim më poshtë.

Boja e shkrimit është ngjyrë blu, ndërsa pena nuk është gjithmonë e njëjtë. Këto ndryshime të penës do të shënohen në aparatën kritik sepse kanë rëndësi për të përcaktuar fazat e ndryshme të shkrimit të veprës.

Më poshtë po sjellim një përshkrim të hollësishëm të çdo kapitulli, si edhe të veçorive që i dallojnë ata:

Kap. I: 32 fl. të numërtuara në krye të fletës. Pena me bojë blu është po e njëjta, me përjashtim të fletës që mban titullin (DIMRI I VETMISË SË MADHE) dhe nëntitullin (Roman), shkruar me një bojë blu më të hapur: me gjasa kjo fletë do të jetë shkruar pasi kishte mbaruar shkrimi i romanit, a së paku, pas kapitullit të parë.

Kap. II: gjithsej 26 fl. të numërtuara në krye të fletës nga nr. 33 deri te nr. 57. Pena ngjyrë blu është po ajo, e njëjtë me penën që u përdor për të shkruar titullin dhe nëntitullin e Kap. I. Anash rreshtit nr. 12 të fl. 43 një yllth shënon pikën ku duhet shtuar teksti i një flete të veçantë që mban numrin autograf (f. 43), i cili në botimin kritik do të shënohet me numrin [43/1] për ta dalluar nga dy pjesët e tjera të fl. 43, të shënuara përkatësisht [43] dhe [43/2]. Për shkak të përmasave të këtyre shtesave autografe, kemi numërtuar progresivisht rreshtat e dy pjesëve [43] dhe [43/2] që i përkasin të njëjtës fletë, ndërsa pjesa [43/1] do të ndjekë një numërtim rreshtash me vete.

Kap. III: gjithsej 33 fl. të numërtuara në krye të fletës nga nr. 58 deri te nr. 87. Pena është me ngjyrë blu, e njëjtë me atë të kapitullit pararendës. Katër fletët e para, që kanë një numërtim progresiv nga 58/1 deri në 58/4, janë shtuar pas shkrimit të parë të kapitullit III: në fakt, në fl. <-58->, është shtuar nr. < /4> e megjithëse më pas janë fshirë, kanë mbetur të lexueshëm qoftë titulli <Kapitulli III> qoftë rreshtat e parë, që i kemi përfshirë në aparatin kritik në brezin gjegjës të fl. 58/4. Në krah të fjalës <ndërronin> të rr. 2 të fl. 59 haset një shenjë e pakuptueshme me laps të kuq, me gjasa e shtuar në shtypshkronjë.

Kap. IV: Në gjithsej 49 fl., të numërtuara rregullisht nga nr. 89 te nr. 133, ka tri fletë të shënuara me nga një yllth me tekste shtesë që futen përkatësisht në fund të fl. 117, në rr. 21 të fl. 124 dhe në rr. 4 të fl. 131. Tekstet e veçanta të dy fletëve të fundit na është dashur t'i numërtojmë veçmas përkatësisht [124/1], [124/2] dhe [131/1], [132/2]. Pena është po e njëjta.

Kap. V: 28 fl. gjithsej të numërtuara progresivisht nga nr. 134 te nr. 161 të shkruara me të njëjtën penë ngjyrë blu. Fletët e numërtuara nga 140 deri te 145 përmbajnë një tekst të daktilografuar që fillimisht i përkiste një vepre tjetër narrative e që autori vendosi ta përfshinte në romanin e ri. Aty ka shumë ndërhyrje që synojnë ta ndryshojnë tekstin origjinal për t'ia përshtatur përmbajtjen dhe stilin veprës së re. Për sa i përket aspektit stilistik, në tekstin kritik nuk i kemi "ndrequr" pjesët që i kanë shpëtuar syrit të autorit pikërisht për të vënë në pah këtë përzierje të pazakontë tekstesh që rrjedhin nga procese të ndryshme krijuese. Kështu që i kemi lënë në versionin origjinal qoftë format foljore në vetë të parë, që gjetkë autori i ka kthyer rregullisht në vetë të tretë duke e përshtatur tekstin me vetën rrëfyese të *Dimrit*, qoftë emrat e personazheve që kanë mbetur ata të veprës së parë origjinale. Duke i ruajtur të dyja versionet tekstore, synojmë të rindërtojmë metodën dhe teknikat krijuese që përdor Kadare në realizimin e universit të tij narrativ. Tek e fundit bëhet fjalë për tekste që i përkasin të njëjtit *Ismailand*.

Kap. VI: 28 fl. gjithsej të numërtuara nga nr. 1 deri në nr. 28, por fleta e parë ka zëvendësuar një tjetër fletë nr. 1. Këtë e dëshmojnë disa shenja fizike: së pari, pena me bojë blu të errët që eliminon numrin e mëparshëm <-90->, të shkruar me të njëjtën penë që ka shkruar tekstin që vijon në fletë; së dyti, ndërprerja e tekstit në fillim të rreshtit të fundit të fletës dhe shënimi i një shigjete që tregon bashkimin me tekstin e fl. 2, na bën të kuptojmë se pjesa e tekstit të fl. nr. 1 është shkruar pasi kishte mbaruar së shkruari i tërë kapitulli, çka do të thotë se autori u kthye prapa për të bërë disa ndryshime ose për të shtuar titullin e pjesës së dytë të romanit. Kjo hipotezë konfirmohet edhe nga "shtesa" të ngjashme, si ajo e fl. 1 të kap. I, ose nga disa të tjera që do t'i shtjellojmë më poshtë.

Kap. VII: gjithsej 33 fl. të numërtuara nga nr. 29 në nr. 61. Asgjë e veçantë për t'u shënuar.

Kap. VIII: edhe në 33 fletët e këtij kapitulli, të numërtuara 62-96, nuk ka asgjë të veçantë për t'u shënuar, përveç fjalës (nevoja) në rr. 21, fl. 70, shkruar me laps të kuq nga redaktori i cili me sa duket e ka pasur të vështirë të lexojë saktë *ductus*-in e autorit.

Kap. IX: nga 97 në 131 janë numërtuar gjithsej 35 fl., të cilave u duhet shtuar një fletë tjetër që përmban një tekst për t'u futur në fl. nr. 110 në pikën e shënuar me një yllth. Këtë pjesë teksti të panumërtuar nga autori, e kemi numërtuar 110/1 sipas modelit të përdorur në raste të ngjashme.

Kap. X: 33 fl. të numërtuara nga 132 në 164 janë shkruar me dy pena të ndryshme, të dyja me bojë blu: me penën e parë janë shkruar fl. 132-138, me penën e dytë me bojë bojë blu më të hapur është shkruar duke filluar nga fjala (zhurmë) e rr. 12 deri në fletën e fundit 164. Ky ndryshim penash është i rëndësishëm sepse na lejon të dallojmë disa ndërhyrje ndreqëse në tekst, si p.sh. fshirja dhe rishkrimi mes rreshtash i (Bernashtajnit) në rr. 10 të fl. 139, ndërhyrje këto që janë bërë pas shkrimit të gjithë kapitullit dhe që dëshmojnë së paku dy faza shkrimi kronologjikisht të njëpasnjëshme.

Kap. XI: gjithsej 43 fl. të numërtuara nga 165 në 207. Asnjë veçanti për t'u shënuar, përveç nënvizimit me laps të kuq të fjalës (pritjes) (fl. 178, rr. 16), të cilën redaktori nuk e lexonte qartë.

Kap. XII: 32 fl. gjithsej, të numërtuara nga 1 në 28, sepse tri fletët e numërtuara 2/1, 2/2 dhe 2/3 janë shtuar nga autori pasi kishte mbaruar së shkruari kapitullin. Në fakt teksti i këtyre tri fletëve, duke nisur nga pjesa e fshirë në fl. 2, zgjatet aq sa zë tri fletë deri në mesin e fletës së fundit ku autori bën një shigjetë të gjatë për të treguar lidhjen e kësaj pjese teksti me atë të fl. 3 që ishte shkruar më parë si vazhdim i fl. 2. Nuk përjashtohet që rishikimi të këtë përfshirë edhe fletën e parë ku numri origjinal (-202-) është fshirë dhe është zëvendësuar me nr. (1) për çka është përdorur e njëjta penë blu me të cilën është bërë ndryshimi i numrit në kap. VI. Pas të gjitha gjasave, së paku në këtë rast të fundit, autori do të ketë nisur ndarjen në pjesë të romanit, duke i vënë edhe nga një titull pjesëve të ndryshme.

Kap. XIII: gjithsej 24 fl. të numërtuara nga 29 në 52. Asgjë e veçantë për t'u shënuar.

Kap. XIV: gjithsej 41 fl. të numërtuara nga 53 në 93. Vihet re përdorimi i penave të ndryshme, të gjitha me bojë blu ku më të errët e ku më të hapur: pena e përdorur deri në rr. 14 të fl. 60 zëvendësohet nga një tjetër me ngjyrë më të hapur, e ngjashme me atë të kap. X. Me këtë penë është shkruar pjesa e tekstit që shkon deri te rr. 19 i fl. 79, ku autori ndërron përsëri penën. Me këtë penë të re është bërë plotësimi mes rreshtash i (gjë) në rr. 8 të fl. 71, shenjë e qartë kjo e një gabimi të bërë gjatë kopjimit dhe jo gjatë shkrimit.

Pjesa tjetër e tekstit është shkruar me këtë penë të fundit, që do të përdoret edhe për kapitujt e tjerë.

Kap. XV: 40 fl. të numërtuara nga 94 në 133 pa asgjë të veçantë për t'u shënuar.

Kap. XVI: Nga 134 në 177 janë numërtuar gjithsej 45 fl. njëra nga të cilat, fl. nr. 175/1, plotëson fl. nr. 175 në pikën ku autori ka vënë një yllth. Pra teksti i fl. 175 është ndarë në dy pjesë, duke mbajtur të pandryshuar edhe numërtimin progresiv të rreshtave. Janë përdorur disa pena me bojë blu: me një penë blu të errët, të ngjashme me atë që hasëm në kapitujt pararendës, është shkruar teksti deri në rreshtin e fundit të fl. 175. Pena e përdorur nga fl. 176 është po ajo me të cilën autori shkruan disa plotësime mbi rr. 2-3 dhe 15 të fl. 175 dhe 175/2, si edhe pjesën e tekstit që zë fl. 175/1. Këto ndërhyrje dëshmojnë se autori iu kthye këtij kapitulli edhe pas shkrimit të tij të parë. Së fundi, me një laps të kuq janë rishkruar yllthet e fl. 175 dhe fl. 175/1. Në rr. 5 të fl. 156 anash emrit (rrufë) po ai laps i kuq shënon vështirësi leximi nga ana e redaktorit.

Kap. XVII: gjithsej 32 fl. të numërtuara nga 178 në 209. Vihet re përdorimi i disa penave bojë blu: e para, më e errët, ndërpritet në rreshtin e dytë të fl. 178; e dyta, më e hapur, vijon deri te rr. 16 i fl. 200 për t'u zëvendësuar nga një penë e tretë me ngjyrë më të errët se e para. Me këtë penë shkruhen fletët 200-209 dhe bëhen plotësimet e shumta mes rreshtash në fletët e shkruara me pena të tjera, më saktë në rr. 7 të fl. 178, në rr. 20-22 dhe 26 të fl. 18, në rr. 15-16 të fl. 184, në rr. 1, 7 dhe 11 të fl. 185, në rr. 12 të fl. 186, në rr. 9 të fl. 188, në rr. 17-19 dhe 23 të fl. 190, në rr. 17-19 të fl. 191, në rr. 7 të fl. 198. Këto ndërhyrje janë më së shumti plotësime të mirëfillta, por edhe ndreqje dhe ndryshime emrash personazhesh dhe vendesh, çka dëshmon se vepra ishte ende në zhvillim e sipër. Vlen të shënohet, së fundi, nënvizimi me laps të kuq i fjalës (përshpëresë,) (rr. 18, fl. 204), neologjizëm që vetë autori në versionin përfundimtar të botuar e zëvendësoi me (në gjoks).

Kap. XVIII: gjithsej 58 fl. të numërtuara nga 210 në 265. Fleta e numërtuar 211/1 plotëson tekstin e fl. 211. Një fletë tjetër me numrin autograf (220) përmban një fragment teksti të fshirë, që e kemi sjellë në aparatin kritik krahas nr. [220/1]. Edhe këtu ka disa ndërhyrje të bëra me të njëjtin laps të kuq: një shenjë e e parëndësishme në rr. 3 të fl. 212, një kllapë katrore në fl. 265 anash fjalës "humbon" dhe numri "350", që i referohet numrit të faqes së parë të kapitullit XIX, që përkon qoftë me versionin e daktilografuar, qoftë me versionin e botuar të romanit. Këto shënime me laps të kuq pas gjasash do të jenë bërë nga daktilografistët e dorëshkrimit ose nga redaktorët e shtypshkronjës. Së fundi shënojmë se pena është e njëjtë me atë të kapitullit pararendës.

Kap. XIX: gjithsej 43 fl. të numërtuara nga 266 në 306, prej të cilave

fletët 277/1 dhe 288/1 janë plotësime të fl. gjegjëse 277 dhe 288, të cilat janë rinumërtuar përkatësisht 277/2 dhe 288/2. Një veçanti e këtyre fletëve është se janë përdorur disa pena: e para, e njëjtë me atë të kapitullit pararendës, është përdorur deri në mesin e rr. 8 të fl. 276, pas të cilit është përdorur një penë me bojë më të hapur deri në rr. 12 të fl. 279. Nga rr. 9 i fl. 286 përdoret një penë e tretë deri në rr. 1 të fl. 288 ku do të ndërrohet me penën e dytë që do të përdoret deri në fund të kapitullit. Përdorimi i disa penave jo vetëm që na shtyn të mendojmë se procesi i shkrimit do të jetë ndërprerë disa herë, por na konfirmon teknikën krijuese të Kadaresë, i cili shpesh kthehej prapa për të modifikuar tekstin. Në këtë kapitull, p.sh., autori është kthyer prapa duke shtuar fl. 277/1, që është shkruar me një penë të ndryshme nga ajo e fl. 277, por e njëjtë me atë që haset nga fl. 279. Kemi edhe këtu dy shenja me laps të kuq në rr. 22 të fl. 267 që tërheqin vëmendjen mbi (citat), fjalë e cila me sa duket nuk është kuptuar nga redaktori.

Kap. XX: gjithsej 42 fl. të numërtuara nga 1 në 41, përfshirë edhe një fletë të panumërtuar me një tekst për t'u futur në një pikë të shënuar me yllth në fl. 20: këtë fletë e kemi numërtuar [20/1], ndërsa pjesën e dytë të fl. 20 e kemi numërtuar [20/2]. Vlen të shënohet se titulli i pjesës së IV është shkruar me një penë të ndryshme nga ajo e tekstit të kapitullit, çka dëshmon edhe një herë se aparati i brendshëm titullor janë shtuar pasi kishte mbaruar shkrimi i romanit.

Kap. XXI: Fleta e parë është pa numër autograf, ndërsa për të tjerat vijon numërtimi progresiv prej kapitullit paraparak nga 43 në 74 për gjithsej 35 fl., dy prej të cilave përmbajnë tekste shtesë: fl. 45/1 plotëson tekstin e fl. 45, ndërsa një fletë tjetër pa numërtim autograf që e kemi numërtuar 46/1, plotëson tekstin e fl. (46). Edhe këtu, si më lart, në aparatën kritik kemi bërë ndarjen e pjesëve të teksteve në 45/2 dhe 46/2. Pena e përdorur është gjithmonë e njëjta për të gjitha fletët, por vihen re disa ndërhyrje ndreqëse me pena të ndryshme, si në rr. 5 të fl. 43 dhe në rr. 7 të f. 45/1, çka dëshmon edhe një herë se këto ndërhyrje i përkasin një faze të mëvonshme shkrimi.

Kap. XXII: 27 fletët e këtij kapitulli mbajnë një numërtim autograf të gabuar në dy pika: nga nr. (90) kapërcehet në nr. (92) dhe nga nr. (93) kapërcehet në nr. (95). Pra numërtimi i saktë shkon nga 75 në 101, çka ndryshon edhe numërtimin e kapitullit pasardhës. Janë përdorur dy pena të ndryshme, njëra më e errët deri në rr. 8 të fl. 84 dhe tjetra më e hapur në fletët që vijnë. Ndryshimi i bojës na ndihmon në vëmë re ndërhyrjet e ndryshme që janë bërë më vonë mbi rreshta.

Kap. XXIII: Numërtimi i ri nga 102 në 124 i 23 fletëve të këtij kapitulli zëvendëson numërtimin autograf nga 104 në 126 që rrjedh prej gabimit të bërë në kapitullin pararendës. Asgjë tjetër për t'u shënuar.

Kap. XXIV: janë gjithsej 43 fl, të numërtuara nga 1 në 40, me dy fletë të shtuara që mbajnë numërtimin autograf (24/I) dhe (24/II) me një tekst që plotëson atë të fl. 24. Fleta e dytë e shtuar mban një shigjetë të gjatë që tregon pikën e lidhjes me fl. 25. Kujtojmë se edhe këtu e kemi ndarë tekstin sipas modelit të përdorur në raste të ngjashme, pra në 24/1 dhe 24/2. Këtyre fletëve do t'u ishin shtuar tri të tjera, që i kemi numërtuar përkatësisht 7, 22 e 28, sikur të mos ishin fshirë nga autori. Këto ndreqje dhe ndërhyrje i kemi pasqyruar në aparatin kritik me nr. [7v, 22v, 28v]. Anash rr. 1 të fl. 8 vihet re një ndërprerje që shënohet me disa pika dhe me një shigjetë që tregon pikën e lidhjes mes dy pjesëve të tekstit. Është e qartë se kemi të bëjmë me një operacion qepjeje tekstore mes tri varianteve që u përkasin fazave të ndryshme të shkrimit. Së fundi, rëndësi të veçantë ka shkrimi me penë të zezë i titullit të pjesës V, bashkë me fshirjen e nr. (-434-) dhe zëvendësimin me nr. (1), ndërhyrje që, sikurse e thamë më lart, është bërë pas shkrimit të tekstit të romanit.

Kap. XXV: Nga 41 në 79; janë gjithsej 41 fl., dy nga të cilat fl. 64/1 dhe fl. il 64/2 të lidhura me kapëse njëra mbi tjetrën plotësojnë fl. 64, teksti i së cilës është ndarë në katër pjesë: [64, 64/1, 64/2, 64/3]; në fletën e dytë me numrin autograf 64/2 një shigjetë shënon pikën e lidhjes me fl. 65. Ndryshe ka vepruar autori me fl. 57: kjo fletë në krye të herës mbante numrin autograf (56/1), sepse ishte menduar si plotësim i fl. (56); më pas fleta është prerë në mes dhe pjesa e sipërme i është mbivendosur me kapëse ish-fletës nr. (57), numër i cili u fshi, pasi i kaloi fletës pararendëse. Vihet re edhe një nënvizim vertikal me laps të kuq i bërë në redaksi anash rr. 3 të fl. 61.

Kap. XXVI: 30 fl., nga nr. 80 në nr. 109, të cilave u shtohet një fletë tjetër që i korrespondon faqes *verso* të fl. 80, tekstin e së cilës, të fshirë nga autori, e kemi sjellë në aparat kritik me nr. fl. [80v].

Kap. XXVII: I gjithsej 28 fl. të numërtuara nga 110 në 137, që nuk paraqesin veçanti për t'u vënë në dukje, përveç nënvizimit me laps të kuq të fjalës (muzeumeve) (rr. 13, fl. 135). Fleta e fundit (fl. 137) mbaron me shënimin (fund) dhe datën (1972 – 8 shtator).

2.2.– *Dorëshkrimi* β

Dsh. β përbëhet nga dy materiale të ndryshme, por të lidhura ngushtë mes tyre. Materiali i parë përmbledh 116 fl. të daktilografuara, të gjitha të numërtuara, që përmbajnë kopjen e daktilografuar të *dsh. α*. Në vijim po sjellim fletët e numërtuara që na kanë mbërritur, duke saktësuar se ato me yllth janë kopje identike mbi të cilat Kadare ndërhyri dy-tri herë duke bërë të njëjtat ndryshime:

244, 250, 254, 255, 258, 260, 261, 261*, 272, 272*, 272**, 273, 273*, 273**, 276, 276*, 278, 278*, 280, 280*, 280**, 293, 298, 298*, 298**, 300, 300*, 301, 302, 307, 307*, 308, 313, 313*, 314, 314*, 315, 319, 321, 321*,

330, 330*, 331, 332, 332*, 333, 333*, 334, 334*, 334**, 337, 337*, 337**, 344, 344*, 345, 345*, 345**, 347, 347*, 347**, 348, 348*, 350, 350*, 351, 351*, 353, 354, 354*, 354**, 355, 355*, 356, 356*, 356**, 356***, 356****, 356*****, 360, 361, 361*, 367, 367*, 370, 388, 397, 435, 435*, 437, 437*, 440, 440*, 444, 452, 452*, 464, 465, 471, 473, 478, 482, 482*, 482**, 495, 496, 497, 497*, 498, 498*, 565.

Mbi këtë “kopje të pastër” autori kreu një tjetër rishikim tekstor, buke bënë ndreqje dhe shtesa të ndryshme mbi versionin dorëshkrim të *dsh.* α , fakt ky që konfirmohet nga krahasimi i dy versioneve α dhe β . Është e qartë se ky material merr një rëndësi të veçantë për rindërtimin e asaj faze të shkrimit që nga njëra anë pason menjëherë fazën e dokumentuar nga *dsh.* α dhe nga ana tjetër paraprin fazën përfundimtare të shtypit.

Dëshmi të mëtëjshme të ndryshimeve të kryera gjatë kësaj faze i gjejmë në grupin e dytë të materialeve, të cilat dallohen nga të parat sepse janë në dorëshkrim. Është fjala për 25 fl. autografe me pjesë teksti të përmasave të ndryshme të shënuara me nga një yllth që tregon pikën ku duhen futur, më saktë në fl. 272, 273, 307, 313, 314, 333, 334, 337, 345, 347, 435, 452, 354, 356, 482, 497, 498. Disa nga këto materiale dorëshkrimore – pikërisht fl. 354, 482, 272 e 273 – përmbajnë secila nga dy-tri karta, ndërsa fl. 356 përmban pesë karta. Është rasti për të përmendur kolofonin që gjendet në fund të fl. 398 ku lexojmë (Fund – Tiranë 1971-1972).

Nuk ka dyshim se këto materiale, qoftë ato të daktilografuara, qoftë edhe dorëshkrimet e grupit *dsh.* β , përbëjnë pjesën e mbetur të kopjes që me siguri u përdor në shtypshkronjë për variantin e shtypur. Nuk dimë se ku përfunduan fletët që mungojnë, të cilat përbënin pjesën kryesore të këtij fashikulli. Mund të supozojmë se ato humbën ose u eliminuan në redaksi, pasi nuk shërbenin më për procesin e shtypit. Gjithsesi kjo humbje nuk ka shumë peshë, sepse përmes një krahasimi të *dsh.* α me variantin e shtypur mund ta rindërtojmë *a posteriori* pjesën që na mungon nga *dsh.* β . Meqenëse këtë çështje do ta rimarrim më tutje, tani për tani është e domosdoshme të shtjellojmë mënyrën e përdorimit të këtyre materialeve gjatë punës për botimin kritik.

3.– *Historia e shkrimit dhe stemma codicum*

Rindërtimi i procesit të shkrimit të romanit thjeshtohet pjesërisht prej ekzistencës së dy materialeve, *dsh.* α dhe β , të cilat nëse nga njëra anë dokumentojnë qartë dy faza të shkrimit, që më poshtë po i quajmë faza α dhe faza β , nga ana tjetër shtrojnë disa pyetje mbi dy periudhat që përkatësisht i paraprijnë dhe i pasojnë ato faza. Historia e shkrimit të tekstit të romanit ka në fakt një kufi të sigurt kohor *ante quem* që shënohet nga botimi i shtypur, por nuk dimë ende me siguri çastet e tjera kyçe që shënojnë fillimin dhe vazhdimin e punës së shkrimit. Edhe sikur të marrim

për të mirëqenë hipotezën se shkrimi i romanit filloi në vitin 1971, sikurse del nga kolofoni i fl. 498 të *dsh.* β, dhe se mbaroi më 8 shtator 1972, datë që shfaqet në kolofonin e fl. 137 të kap. XXVII të *dsh.* α, mbetet për t'u shqyrtuar mbi bazën e elementeve jashtëtekstore dhe kontekstore puna parapërgatitore që bëri Kadare, por duhet edhe përqëmtuar mundësia e një faze të tretë të rishikimit të veprës që do të jetë zhvilluar në periudhën mes fazës β dhe botimit të shtypur, që po e quajmë faza S. Në çdo rast mbeten ende për t'u fiksuar kufijtë kohorë relativë, me synimin për të nxjerrë në dritë elementet e ndërveprimit mes tekstit dhe kontekstit. Në këtë suazë dëshmitë që na ka dhënë Helena Kadare në librin e saj me kujtime marrin një rëndësi të veçantë për të dalluar së paku katër çaste kyçe të historisë së shkrimit të romanit që do t'i shtjellojmë hollësisht më poshtë.

1.– Faza parashkrimore (ω). Pavarësisht nga arsyet që e shtynë Kadarenë të merrej me “ngjarjet” e Moskës të vitit 1960 dhe me pasojat politiko-ideologjike që rrodhën nga prishja e marrëdhënieve me Bashkimin Sovjetik të Hrushovit, jemi të sigurt se ai filloi të mblidhte të dhëna në Arkivin e Komitetit Qendror aty nga fundi i vitit 1969 dhe se tashmë projekti i romanit të ardhshëm u përvijua gjatë vitit 1970. Në fakt, sipas kujtimeve të së shoqes deri në pranverën e atij viti

«Is po shkruante [...] me ngut *Kronikë në gur*. Donte të përfitonte që ta botonte së paku edhe atë roman përpara se të fillonte ndonjë ngatërresë me romanin e grindjes me rusët. Nuk kishte shkruar asnjë radhë nga ky i fundit...»³.

Gjithmonë sipas Helena Kadaresë, në vjeshtën e vitit 1970, autori e kishte «ravijëzuar arkitekturën e përgjithshme të *Dimrit të vetmisë së madhe*»⁴.

Ravijëzimi i kësaj arkitekture ka rëndësi relative, sepse nuk përfshin shkrimin e veprës, por kufizohet në një fazë parashkrimore të saj. Këtë na e konfirmon sërish Helena Kadareja kur thotë se «viti 1970 po mbyllej me qetësi. Is kishte skicimin e “romanit të grindjes”, por ende s’kishte filluar ta shkruante»⁵. Në fakt pasi mendoi strukturën e romanit, Kadare nuk vijoi menjëherë punën për shkrimin e tij, por i dha përparësi përfundimit të romanit *Kronikë në gur*, që do të botohet në vitin 1971, dhe punoi mbi dy romane të tjera «njërin gati të mbaruar, *Muzgu i perëndive të stepës* dhe tjetrin të porsafilluar, *Pashallëqet e mëdha (Kamarja e turpit)*»⁶, romane që do të botohen aty nga mesi i atij dhjetëvjeçari.

3 Helena Kadare, *Kohë e pamjaftueshme*, cit., f. 227-228.

4 *Po aty*, f. 157.

5 *Po aty*, f. 246.

6 *Po aty*, f. 247.

3.2.– Shkrimi i parë i plotë (faza α). Pasi u mbyll faza e parë e mbledhjes së materialeve arkivore dhe e skicimit të strukturës së përgjithshme të veprës, Kadare iu vu punës për shkrimin e *Dimrit* në muajt e parë të vitit 1971 për ta përfunduar atë, sikurse e thamë, më 8 shtator 1972. Përveçse na konfirmon tërthorazi këtë datë⁷, Helena Kadare dëshmon se procesi i shkrimit të romanit kishte vazhduar gjatë gjysmës së parë të vitit 1971, megjithëse në maj të atij viti «*Dimri*, në mos gaboj, nuk ishte shkruar as gjysma»⁸.

Këto kujtime të bashkëshortes së shkrimtarit janë dyfish të rëndësishme, sepse nga njëra anë konfirmojnë kufirin kohor *post quem* të shkrimit të *dsh. α* gjatë muajve të parë të atij viti, nga ana tjetër, duke përmendur takimin e autorit me Enver Hoxhën, na thotë se pikërisht me atë rast Kadare mësoi nga goja e diktatorit disa hollësi që kishin të bënin me «ngjarje nga Moska, siç qe darka në Kremlin, në prag të mbledhjes së famshme, si edhe nata që pasoi, ajo që Is e ka përshkruar te *Dimri* si “nata e zimave të zinj”»⁹. Këto shënime na lejojnë të përcaktojmë me njëfarë sigurie se në kohën kur u krye vizita në shtëpinë e diktatorit, shkrimi i romanit nuk mund të kishte shkuar përtej pjesës së parë, pra nuk ishin shkruar ende kapitujt e pjesës së dytë ku përshkruhen ngjarjet e Moskës, të cilat autori vështirë se mund t'i mësonte nga dokumentet arkivore.

Procesi i shkrimit të *dsh. α* , që vijoi me disa ndërprerje, është i thjeshtë për t'u rindërtuar, sepse dorëshkrimi autograf nuk paraqet anomali të tilla që të kërkojnë kërkime jashtëtekstore, por njëherazi ofron shumë elemente të dobishme për studimin analitik të procesit krijues dhe të stilit të punës së Kadaresë duke na ndihmuar të zbulojmë sekretet e shkrimtarit dhe të zbërthejmë nivelet e tij shprehëse deri te tiparet gjuhësore më elementare. Është, pra, një minierë të dhënash, karakteristikat e të cilave janë të tilla që i hapin udhën një interpretimi më objektiv të tekstit duke krijuar kushtet për një vlerësim estetik të denjë për kompleksitetin e veprës kadareane. Natyrisht, nuk është vendi këtu për të zhvilluar analiza të tilla, të cilat mbeten për t'u shtjelluar në një vëllim më vete. Është rasti këtu të kujtojmë se varianti i *dsh. α* dëshmon një gjendje lirie krijuese vërtet të jashtëzakonshme, sikurse na thotë edhe Helena Kadare:

«Is po vazhdonte të shkruante *Dimrin*. E bënte këtë punë me kënaqësi, pa pasur ndjenjën se po kryente diçka të detyrueshme, ose se “po paguante taksën”, siç thuhej. Ai po e shkruante romanin e grindjes me rusët, siç do të shkruante çdo vepër tjetër. Me të njëjtën kënaqësi dhe me të njëjtin ritual. Siç ma kishte shpjeguar vetë disa herë, para se të fillonte diçka ai bënte

7 «Vitet 1972 po i afrohej fundit. Is sapo kishte mbaruar së shkruari romanin»: *Po aty*, f. 302.

8 *Po aty*, f. 284.

9 *Po aty*, f. 286.

një test të fshehtë. Testi ishte ky: a do ta shkruante dhe si do ta shkruante këtë vepër në qoftë se nuk do të jetonte në Shqipëri, por diku gjetkë, ta zëmë në Zvicër? (Kisha vënë re se ky vend iu kujtohej të gjithëve, kur ishte fjala për asnjësi.) Testi kishte këto përgjigje: Nuk do ta shkruante. Do ta shkruante, por fare ndryshe. Do ta shkruante pothuajse njëllor si në Shqipëri. Is i kishte mbushur mendjen vetes se historinë shqiptaro-ruse do ta shkruante *pothuajse* siç do ta shkruante po të ishte i lirë, me fjalë të tjera, siç do ta shkruante në atë “kohën tjetër”»¹⁰.

3.– Rishikimi i parë i veprës (faza β). Faza α mbyllet aty nga fundi i vitit 1972 me dorëzimin e dorëshkrimit në redaksi për t’u daktilografuar. Këtë na e thotë sërish Helena Kadare kur kujton se «dorëshkrimi i *Dimrit të vetmisë së madhe* kishte shkuar në shtyp»¹¹, Këtu fillon faza e dytë e historisë së shkrimit të tekstit, që dokumentohet pjesërisht nga *dsh.* β , ku sikurse e pamë më lart, autori ka ndërhyrë duke bërë ndryshime e plotësime mes rreshtash dhe anash faqes ose duke shtuar fletë të reja dorëshkrim me fragmente më të gjata teksti. Këto ndërhyrje janë të tilla që dëshmojnë se dy materialet janë të lidhura logjikisht aq ngushtë mes tyre, sa mund të themi pa hije dyshimi sa njëri rrjedh kronologjikisht pandërmjetshëm nga tjetri: në fillim α e pastaj β .

Ndërhyrjet në *dsh.* β përvijohen si një shtresëzim i mëtejshëm variantesh që modifikojnë strukturën tekstore, por jo arkitekturën e përgjithshme të romanit që në fakt mbetet e pandryshuar. Kjo fazë shkrimi përkon me një rafinim stilistik që konkretisht realizohet me ndryshime, fshirje e plotësime, qe prekin fjalë ose fjali të veçanta, pa cenuar gjithsesi strukturat gjuhësore. Krahasimi mes dy varianteve nxjerr në pah se si në *dsh.* β ruhet idiolekti drejtshkrimor që dëshmohet në *dsh.* α , idiolekt që do të ndryshojë në fazën e fundit të shkrimit, atë të shtypit.

4.– Faza përfundimtare (γ). Procesi i shkrimit vijoi edhe gjatë një faze të mëtejshme, që e dokumentojmë *a posteriori* falë ballafaqimit të dy varianteve α e β nga njëra anë dhe variantit të shtypur nga ana tjetër. Në këtë rast ndryshimet që prekin vetëm nivelin gjuhësor dhe drejtshkrimor, përbëjnë një problem për filologun sepse nuk jemi të sigurt nëse autorësia e tyre i përket autorit apo redaktorëve të shtypshkronjës. Pikërisht në kohën kur vepra dorëzohej në shtyp, në Tiranë po zhvillonte punimet Kongresi i Drejtshkrimit (20-25 nëntor 1972), i cili miratoi rregullat e reja drejtshkrimore që filluan menjëherë të zbatoheshin nga redaksitë e shtëpive botuese. Kjo ndodhi edhe me botimin e *Dimrit*.


Pavarësisht faktit që këto ndryshime prekin vetëm rrafshin gjuhësor,

10 *Po aty*, f. 278.

11 *Po aty*, f. 308.

mbetet gjithsesi problemi filologjik i përcaktimit të vullnetit të autorit, aq më tepër kur ato sollën pasoja kontradiktore: nga njëra anë, u cënuan idiolekti i autorit në emër të “ndreqjes së pasaktësive” fonetike e morfologjike, nga ana tjetër, redaktorët me ndryshimet që i sollën tekstit shkelën vetë rregullat drejtshkrimore të sapovendosura (p.sh. u zëvendësua forma normative “gjithçka” që haset rregullisht në dy dorëshkrimet α e β me “gjithshka” që dëshmohet në botimin e shtypur). Meqenëse diskutimi për këto aspekte do t’i tejkalonte kufijtë e kësaj hyrjeje, do t’i lëmë për t’i trajtuar më hollësisht në vëllimin monografik që do të botohet më vete.

Këto poshtë po paraqesim skematikisht marrëdhëniet mes fazave të ndryshme të shkrimit:



3.- Kriteria për botimin kritik

Këto kohët e fundit në Shqipëri është folur shumë, ndonjëherë edhe pa vend, për kritikën gjenetike, duke iu referuar madje metodologjive që karakterizojnë të ashtuquajturën “shkollë filologjike franceze”, të cilat dallojnë nga praktika ekdotike “kritiko-gjenetike” e “shkollës filologjike italiane”. Të shumta janë dallimet mes këtyre dy shkollave, por po aq të shumta janë edhe pikët e përbashkëta. Më e rëndësishmja ndër këto të fundit është pa dyshim pesha vendimtare e dorëshkrimeve të një vepre, të një autori a të një epoke. Mungesa e objektit të studimit filologjik – pra dorëshkrimit – jo vetëm që e cenon rëndë perspektivën e kërkimit të të dyja shkollave, por i hap udhën keqkuptimeve dhe keqinterpretimeve të arsyeve “pragmatike” mbi të cilat ato bazojnë veprimtarinë e tyre, që tek e fundit e gjejnë shprehjen te botimi kritik i materialeve parapërgatitore të një vepre¹².

12 Këto dhjetëvjeçarët e fundit, qysh kur u pa qartë se përdorimi i kompjuterit do të shndërronte rrënjësisht mjetet klasike të shkrimit artistik, u shtrua një problem që Almuth Grésillon, një nga etërit e kritikës gjenetike, e shprehu në formë pyetjeje dhe e vuri si titull të kapitullit të fundit të librit të tij: “Vers une critique génétique sans brouillons?": shih Almuth Grésillon, *La mise en œuvre. Itinéraires génétiques*, CNRS Éditions, Paris, 2008, f. 269-294. Thelbi i problemit vërtitet rreth dilemës “prania vs. mungesës” së skicave: pak rëndësi ka nëse ato janë në dorëshkrim me bojë mbi

Pikërisht mënyra se si përdoren materialet dorëshkrimore dhe se si botohen ato dallon dy qasjet jo vetëm në planin metodologjik, por edhe në atë teorik. Për shkollën franceze të gjitha materialet janë të dobishme për të dokumentuar gjenezën e një teksti, qofshin këto skica të plota, shënime sporadike, a lista fjalësh. Këto dokumente që përbëjnë të ashtuquajturin avantekst¹³ dhe që Grésillon e konsideron sinonim me *dossier génétique*¹⁴, për shkollën franceze duhen botuar të gjitha pa dallim përmes riprodhimit besnik të origjinaleve. Kjo shpjegon pse në të ashtuquajturin *édition génétique* francez, ndryshe nga ç'ndodh në shkollën filologjike italiane, nuk merren parasysh fazat e ndryshme të procesit të shkrimit dhe as pasqyrohen ato në aparatën kritik. Nuk është vendi këtu të zgjatemi në historinë e zhvillimit teorik të të ashtuquajturit filologji e autorit. Por nuk mund të mos zëmë ngoje faktin se shkolla italiane, e ndjekur nga shkolla gjermane, gjithë duke e vlerësuar rëndësinë epistemologjike të *gjenezës tekstore*, e ka rishikuar teorikisht atë¹⁵, duke konsideruar të domosdoshme, së pari, përzgjedhjen e materialeve dorëshkrimore që na kanë mbërritur, së dyti, pas rindërtimit të fazave të shkrimit, përgatitjen e një botimi kritik të atyre materialeve që filologu gjykon se kanë vërtet peshë në procesin krijues të veprës letrare. Kështu pra, nocioni i *avantekstit* në filologjinë italiane merr kuptim të ri, sepse u referohet vetëm materialeve që kanë një marrëdhënie të drejtpërdrejtë me prodhimin final. Me fjalë të tjera, shkolla italiane e ka zgjidhur dilemën e dinamizmit tekstor duke shtënë në punë një qasje kritiko-gjenetike që, nga njëra anë, synon rindërtimin e procesit të krijimit të prodhimit final përmes kritikës së varianteve, nga ana tjetër, falë përzgjedhjes paraprake të dokumenteve e shmang rrezikun që ka denoncuar Cesare Segre: «po t'i rreshtojmë të gjitha tekstet pararendëse të një veprë në rend kronologjik, nuk do të kemi një diakroni, por një sërë sinkronish të njëpasnjëshme»¹⁶.

Të vetëdijshëm për vështirësitë që paraqet botimi i dy materialeve që

letër apo shkruara me kompjuter e të ruajtura në suporte elektronike. Për studiuesin Grésillon, që e bazon arsyetimin e tij mbi idetë e Umberto Eco-s, kushti i vetëm është «bien redéfinir ce que l'on entend par document génétique, il n'est pas du tout impossible de faire de la critique génétique sans brouillons» (f. 294). Gjithsesi mbetet fakti që pa "dokumentin" kritika gjenetike shndërrohet në një oksimoron shkencor.

13 Ja përkufizimi i "avantekstit" për shkollën franceze: «Depuis J. Bellemin-Noël (1972), on appelle *avant-texte* l'ensemble des documents qui sont produits au cours de la genèse du texte dans la "fabrique", l'"atelier", le "cabinet de travail" de l'auteur. Si le document est écrit à la main, c'est un manuscrit»: Almuth Grésillon - Jean-Louis Lebraye, "Avant-propos" në *Manuscrits-Écriture. Production linguistique*, Langages, 17^e année, n. 69, 1983, f. 7.

14 Shih Almuth Grésillon, *éléments de critique génétique. Lire les manuscrits modernes*, CNRS Éditions, Paris, 1994, f. 285 e 286.

15 Shih Cesare Segre, *Avviamento all'analisi del testo letterario*, Einaudi Paperbacks, Torino, 1985, f. 79-85.

16 *Po aty*, f. 79.

dokumentojnë shkrimin e *Dimrit të vetmisë së madhe*, kemi vendosur të ndërtojmë një aparat kritik të përbërë nga disa breza, duke i dhënë secilit syresh funksione dhe detyra ekdotike të ndryshme.

Brezi α rindërton fazat e ndreqjes që dëshmohen nga dorëshkrimi përkatës, duke sjellë për çdo rast mes kllapash katrore numrin e fletës. Çdo ndërhyrje paraprihet nga numri i rreshtit në tekstin dorëshkrim. Për sa i përket dsh. α , numërtimi i rreshtave për çdo fletë bëhet në çdo pesë rreshta, ndërsa numri progresiv i fletëve shënohet mes kllapash katrore. Fillimi i rreshtit shënohet nga një vizë vertikale. Për t'i bërë të qarta dhe funksionale të dhënat e këtij brezi kemi përdorur një sistem shenjash ta konsoliduar tashmë në të tjera botime kritike.

Brezi β përfshin ndërhyrjet e bëra nga redaktorët e shtëpisë botuese, kryesisht shmangie përsëritjesh ose ndreqje gabimesh dore që i kanë shpëtuar autorit gjatë fazës së shkrimit. Çdo ndërhyrje paraprihet nga një numër që i referohet numërtimit në anën e djathtë të faqes. Këtij sistemi numërtimi i referohet brezi i tretë dhe i fundit γ , ku përmbledhen të gjitha variantet, kryesisht plotësuese, që kanë rezultuar nga ballafaqimi me tekstin e botimit të shtypur. Këto variante ndahen me një kllapë katrore mbyllëse.

Dy brezat α dhe γ ndjekin hullinë e traditës filologjike më të mirë italiane, e cila kërkon që krahas procesit ndreqës të tipit gjenetik, të pasqyrohet edhe zhvillimi kritik i tekstit. Për këtë arsye shpresojmë të kemi përgatitur një protokoll ekdotik që t'i qaset nocionit të “përafrimit të përhershëm ndaj vlerës”, nocion i cili për filologun Gianfranco Contini përfaqëson rindërtimin e vërtetë të dinamizmit krijues që dëshmohet nga dokumentet. Shprehim bindjen se edhe në rastin e romanit të Kadaresë zbulimi i dinamikave të procesit krijues do të ndihmojë në vlerësimin kritiko-letrar të *Dimrit të vetmisë së madhe*.

Bibliografia

Aragon Louis et alii, *Essais de critique génétique*, Flammarion, Paris, 1979.

Contini Gianfranco, *Esercizi di lettura*, Einaudi, Torino, 1982.

Ferrer Daniel, *Logiques du brouillon: Modèles pour une critique génétique*, SEUIL, Paris 2011.

Frashëri Naim, *Bagëti' e Bujqësija (I pascoli e i campi)*. Introduzione, edizione critica, traduzione italiana e concordanza a cura di Francesco Altimari. CELUC, Rende 1995.

Gifford Paul - Schmid Marion, *La création en acte: devenir de la critique génétique*, Rodopi, Amsterdam, 2007.

- Grésillon Almuth - Lebraye Jean-Louis, "Avant-propos" në *Manuscripts-Écriture. Production linguistique*, Langages, 17e année, n. 69, 1983.
- Grésillon Almuth, *Éléments de critique génétique. Lire les manuscrits modernes*, CNRS Éditions, Paris, 1994.
- Grésillon Almuth, *La mise en œuvre. Itinéraires génétiques*, CNRS Éditions, Paris, 2008.
- Hay Louis, *La littérature des écrivains: questions de critique génétique*, José Corti, Paris, 2002.
- Isella Dante, *Le carte mescolate vecchie e nuove*, a cura di Silvia Isella Brusamolino, PBE – Einaudi, Torino, 2009.
- Kadare Helena, *Kohë e pamjaftueshme. Kujtime*, Shtëpia botuese "Onufri", Tiranë, 2011.
- Kadare Ismail, *Dimri i vetmisë së madhe* (Roman), Shtëpia botuese "Naim Frashëri", Tiranë, 1973.
- Kadare Ismail, *Ftesë në studio*, Shtëpia botuese "Onufri", Tiranë, 2004.
- Segre Cesare, *Avviamento all'analisi del testo letterario*, Einaudi Paperbacks, Torino, 1985.
- Shaban Sinani, *Letërsia në totalitarizëm dhe "Dosja K". (Studim monografik dhe dokumente)*, Shtëpi botuese e studio letrare "Naimi", Tiranë, 2011.
- Stussi Alfredo, *Introduzione agli studi di filologia italiana*, Il Mulino, Milano, 2007.
- Sula Lili - Kryeziu Jorina, *Kadare: bibliografia*, II vëll., Botime Pegi, Tiranë, 2015.
- Willemart Philippe, *Critique génétique: pratiques et théorie*, L'Harmattan, Paris, 2007.

Abstract

The present essay revolves around the authentic manuscript and the typescript of the first version of Ismail Kadare's novel "The Winter of the Great Loneliness" (1973). Meticulous description of the manuscript is followed by accurate analysis of the structure of this literary work, which in turn highlights the different initial phases preceding the first edition. The author, then, carries the reader through the multiple stages of the editing process as can be easily deduced from the manuscript sheets. Especially the manuscript is undoubtedly of major importance as it is essential to understanding the style and the language in this Kadarean novel, thus pointing out the wrongful extraliterary interpretations of the detractors of this controversial novel.

DIRRI /
VETMISE
SE MINDHE

Roman

~~PJESA~~ E PARE

Mbarimi i nge vere

KAPITULLI !

[illegible]

pa prulur, ⁸ tume
 Instruaret ishini plot me njerëz. Nga kjer
 e larta ^{administrative} po delnin ^{administrative} me shume
 neqeruesit ^{administrative} pomefente. Hi eci ne e' cote here munda
 nymes si ^{kalimtare} ~~perqer~~ partaj ne lufta e' mek
 kente afgare dhe ne fut me ne bar. Tek ba-
 naku kishte shume njerëz. ~~Shumë e pishkollat~~ Prati
 sa hi vinte aalla duke ueribuar pe pas klamave
 rrengit. Kente ^{shumë} ~~dishta~~ hi e' shume me shume
 si lozmi klamat per hi mende ata qe ishin
 q' ~~partaj~~ kalimtare e nymes nga ata qe

(Handwritten notes on a separate sheet of paper, showing a diagram of a circle with an arrow pointing to it from above, and various scribbles and text.)

ve kurrsë. Populli e kishin duruar pritjen, prova kaloi. Humbjet
 ishin aty, këtu, gropa të thella mbi gjilëra e tij të gjersë, por
 humbjet e bëjnë diçka herë edhe më të madhë një popull. Aua gjish-
 ashtu humbjet më kanë ^{pasuruar} ~~gjithë~~ ^{ka ç'është} ~~gjithë~~ ^{gjithë} Ulurima e sirenës dakej
 sikur kishte mbirë në qiell. Të kësaj pritje gjithë mbasidite
^{hequr} ~~gjithë~~ ^{gjithë} Të kësaj pritje me shokuj.

~~1972 - 8 shtator~~

into schwebenden ngs. ¹⁰ ~~unvollständig~~
^{aussetzt} ~~unvollständig~~, ^{aussetzt} ~~unvollständig~~, ^{aussetzt} ~~unvollständig~~
^{unvollständig} ~~unvollständig~~, ^{unvollständig} ~~unvollständig~~, ^{unvollständig} ~~unvollständig~~
^{unvollständig} ~~unvollständig~~, ^{unvollständig} ~~unvollständig~~, ^{unvollständig} ~~unvollständig~~
 stehen, für ~~unvollständig~~ ~~unvollständig~~
~~unvollständig~~ ~~unvollständig~~
 jenen ~~unvollständig~~ ~~unvollständig~~.

f. 498 se kurri. Populli e kën durrues goditjen.

(X)

~~qatë shtetëshmërisë mbledhura kruspull~~
~~qatë shtetëshmërisë mbledhura kruspull~~
Kishte shtetëshmërisë shtetëshmërisë
qatë mbledhura mbledhura kruspull, duke mbledhur
mbledhur aty kështu vlerën dhe shtetëshmërisë, nga
shtetëshmërisë për jetën e kështu rrejtur, shtetëshmërisë
~~aromën e saj, eterne, të bardhë, Prova~~
~~kalori. Eklipsi, dritë anësore mbledhur, po~~
~~qatë të pastërformuar.~~
Te bardhë ^{humbet kaosit.} të pastërformuar. Prova kalori.
Humbet nën aty-kështu, gropa të
thella mbledhur shtetëshmërisë e tij të shtetëshmërisë, për
humbet e bejme dritë herë edhe më
të madhërisë popull. Më shtetëshmërisë humbja
më ka pasuruar, tha ai me vete. Më
rrejtur e shtetëshmërisë duke shtetëshmërisë
më shtetëshmërisë. Te kam pritur shtetëshmërisë
mbledhur ai. Te kam pritur me shtetëshmërisë.

Fundi

Tirane 1971-1972